



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:216716
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571047

C.nr.649/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve K.B, nga Rahoveci, dhe S.B, S.B, me vendbanim, Prizren, të cilët i përfaqëson av. D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës B me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë përfaqësuesit e autorizuar, D.S, L.S, D.I të tretë nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 5,015.00 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia paditësve K.B, dhe S.B, të dytë nga Rahoveci.

II. OBLIGOHET e paditura B me seli në Prishtinë, që paditësit K.B, nga Rahoveci, në emër të dëmit material ti paguaj shumën prej 1,015.00 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 18.10.2022, e gjerë te pagesa definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

III. OBLIGOHET e paditura B me seli në Prishtinë, që paditëses S.B, nga Rahoveci, në emër të dëmit material dhe jo material të kompensoj dëmin dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,200,00 Euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,000,00 Euro, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjerë te pagesa definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.
- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huajë400,00 Euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar.....400,00 Euro, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 29.09.2022, e gjerë te pagesa definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim.

IV. Përtej shumës të kërkesëpadisë së precizuar kërkesëpadia e paditësit REFUZOHET.

V. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses S.B, që e paditura t'ia paguaj në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik shumën prej 500,00 Euro, si e pabazuar.

VI. OBLIGOHET e paditura që paditësve K.B, dhe S.B, ti paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1,827.00 €uro, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

VII. Refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi A.K nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka ushtruar padi kundër të paditurës B me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. D.M, me parashtresë të veçantë prej datës 06.11.2022, ka bërë zgjerimin e padisë dhe kërkesëpadisë në aspektin subjektiv dhe objektiv, ku si paditëse duhet të jetë edhe S.B, me vendbanim, Prizren.

E paditura B me seli në Prishtinë, me parashtresën e saj në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e kërkesëpadisë.

Sipas kësaj çështje juridike janë caktuar disa seanca të shqyrtimit kryesor në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësve Av. D.M dhe përfaqësuesit e autorizuar e të paditurës D.S, L.S, D.I.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati D.M gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, kërkesës së saj, si dhe pranë zgjerimit të padisë, duke shtuar se e paditura në procedurë administrative për të dy paditësit ka dhënë oferte për kompensim në bazë të plot të përgjegjësisë andaj edhe kontestojnë se nuk është kontestuese baza juridike andaj për vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë gjegjësisht dëmit material në automjet i propozoi gjykatës marrjen provave me ekspertizë të makinerisë ndërsa për konstatimin dhe për caktimin e llojit të lartësisë së lëndës si pasoj e lëndimeve, propozoi marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë. Pas pranimit të ekspertizës së komunikacionit rrugor të punuar nga ing. B.K, për të njëjtën nuk ka vërejtje dhe nuk kërkon sqarime nga ana e ekspertit, u konfirmua se shkaktori i vetëm i këtij aksidenti është mjeti motorik i pa regjistruar gjegjësisht i pa siguruar, andaj edhe përgjegjësia në aspektin pasiv në procedurë i takon të paditurës B. Meqenëse e kanë të vlerësuar dëmin material në automjetin e paditësit K.B, sipas ekspertizës së dt. 09.07.2023, me qëllim të vërtetimit së lartësisë së dëmit gjegjësisht të lëndimeve trupore te paditësja S.B, i propozoi gjykatës që të abrogohet aktvendimi procedural i datës 07.06.2023, ku janë caktuar ekspertë mjekësore Dr. V.B dhe Dr. V.B-R dhe të aprovohet propozimi për caktimin e eksperteve mjekësore dr. I.S nga Prizreni dhe dr. N.F nga Prizreni. Me nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit është vërtetuar se e paditura bartë përgjegjësi 100 % në këtë aksidente trafiku, po ashtu në lidhje me lartësinë e dëmit në automjetin e paditësit K.B, është vërtetuar përmes ekspertizës së datës 09.07.2023, lartësia e dëmit në shumën prej 1,015.00 €, ndërsa me provat ekspertiza mjekësore është vlerësuar dhe është vërtetuar se paditësja S.B, i është shkaktuar dëm material dhe jo material si pasojë e lëndimeve, gjegjësisht dhimbjet fizike, frikë të përjetuar dhe forma tjera, si në ekspertizën mjekësore ortopedike dhe psikiatrike. Gjegjësisht është vërtetuar në tërësi kërkesa e precizuar si me poshtë, andaj i propozojmë

Gjykatës që kërkesëpadinë e precizuar ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Si dhe të obligohet e paditura në shpenzimet e procedurës në shumën prej 1,995.00 €uro.

Përfaqësuesit e autorizuar e të paditurës D.S, L.S, D.I, kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë përgjigjes në padi të ushtruar me datë 30.11.2021, ku edhe më tutje e paditura mbetet pranë pretendimeve si në përgjigje si dhe përgjigje në padi për faktin se sipas raportit shkaktar i aksidentit ka drejtuar mjetë të punës motokultivator-golldan ku në bazë të dispozitave ligjore të njëjtat nuk i nënshtrohet sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, andaj edhe propozimet për nxjerrjen e provave me ekspertizë i kundërshtoi si nga atë nga na e makinerisë edhe mjekësore. E paditura e konteston bazën juridike të kërkesëpadiës sa i përket rrjedhës së aksidentit sepse në bazë të raportit të aksidentit nuk është vërtetuar se kush ka dhënë kontribut për shkaktimin e këtij aksidenti, e po ashtu në këtë seancë vazhdojnë që të kontestojnë legjitimitetin pasiv të të paditurës. E paditura e konteston legjitimitetin mbi bazën e ligjit 05 L-123 për automjete përkatësisht duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1.3, neni 54 par. 1.2 dhe 1.3 dhe neni 66 dhe kontestimin e legjitimitetin nuk e bazon aktet nënligjore ndërsa lidhur me propozimin për nxjerrjen e provës nga lëmia e komunikacionit të njëjtën e lejnë në vlerësim gjykatës. E paditura pavarësisht konkludimeve të nxjerra në ekspertizë të komunikacionit vazhdon të konteston legjitimitetin pasiv pasi që automjeti që pretendohet se ka shkaktuar aksidentin është mjet pune dhe nuk është i detyruar ti nënshtrohet sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia. E paditura bën kompensimin e palëve të treta vetëm në ato raste kur shkaktari ka detyrim sigurimin e automjetit, e në rastin konkret shkaktari nuk ka pasur obligim sigurimin e mjetit të punës, andaj përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie tek shkaktari i aksidentit. Si rrjedhojë e lartë cekurave po ashtu nxjerrja e ekspertizës së makinerisë të cilën e kanë pranuar në seancën e kaluar për të paditurën është i relevantë andaj kërkoi nga i autorizuari i paditësit që në raport me të paditurin të tërheq padinë në mungesë të legjitimitetit pasiv. Sa i përket propozimit për nxjerrjen e provës nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë të njëjtat i kundërshtoi për arsytet e sipër cekura. B bën kompensimin e palëve të treta vetëm në atë raste kur shkaktari ka detyrim sigurimin e automjetit, në rastin konkret shkaktari nuk kishte obligim sigurimin e mjetit të punës, andaj edhe nuk mund të konsiderohet si përgjegjëse dhe palë për kompensim të dëmit, por përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie tek shkaktari i aksidentit - pra tek drejtuesi i mjetit të punës Motokultivator — B. Edhe po të konsiderohej përgjegjëse e paditura e konteston shumën e kërkuar nga paditësit me anë të precizimit të kërkesëpadiës dhe atë, frikën e përjetuar është jashtëzakonisht e lartë dhe në kundërshtim direkt me nenin 183 par.2 të LMD-së, i cili parasheh se me rastin e vendosjes së kërkesës për shpërblim të dëmit jo material, si dhe lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të, të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj. Meqenëse e paditura nuk i ka dhënë shkas padisë, i propozoi gjykatës që të refuzoj në tërësi shpenzimet e kërkuara të procedurës, por edhe si kërkesë e tillë nuk është e drejtë sepse kemi dy seanca të shtyera pa fajin e të paditurës, përkatësisht seancat e datës 09.10.2023 dhe 08.11.2023.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar këto provat: ka bërë shikimin në raportin e aksidentit nr.2022-ER-417 i datës 22.07.2022, ka bërë shikimin në certifikatën e regjistrimit të automjetit me numër CRA 1725978, ka bërë shikimin në polisën e sigurimit me numër 0008041867, ka bërë shikimin në ekspertizën e komunikacionit të datës 05.08.2023, ka bërë shikimin në ekspertizën për vlerësimin e dëmit material në automjet të datës 09.07.2023, si dhe ka bërë shikimin në raportet mjekësore për paditësit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e administruara është vërtetuar se me datë 22.07.2022, në rrugën në drejtim Optrushë – Rahovec, është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor, në të cilin aksident shkaktohen dëme të mëdha materiale dhe lëndime trupore pëson paditësja S.B, si dhe dëme materjale në automjet paditësi K.B, nga kjo gjendje faktike e duke u mbështetur në provat e lartë cekura gjykata iu fali besimin raportit policor nr. 2022-ER-417 i datës 22.07.2022.

Me administrimin e certifikatës së regjistrimit të automjetit me numër CRA 1725978,, gjykata vërtetoi faktin se paditësi K.B, ka pasur veturën e regjistruar.

Me administrimin e polisës së sigurimit me numër 0008041867, gjykata vërtetoi faktin se paditësi K.B, ka qenë i siguruar tek E.

Me administrimin e ekspertizës së ekspertit të komunikacionit B.K të datës 05.08.2023, gjykata vërtetoi faktin se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve teknike të ngasësit të motokultivatorit B.

Me administrimin e ekspertizës për vlerësimin e dëmit material në automjet B S. K, të datës 09.07.2023, gjykata vërtetoi faktin se vlera e dëmit të llogaritur të shkaktuar si pasojë e aksidentit është: V. (Dëmit) = 1,015.00 Euro.

Me administrimin e ekspertizës së ortopedisë të Dr. I.S të datës 05.12.2023, i cili ka deklaruar se ekspertizën respektivisht raportin dhe mendimin e tij ka konstatuar se paditësja S.B ka pësuar ndrydhje të mesit (lumbale) të cilat shtohen si grua shtatëzane në javën e 34 (3 javë para lindjes). Dhembjet fizike me intensitetin të rëndë: 24 orë, të intensitetit mesatar: 3 javë (gravidance 34 javësh), të intensitetit të ulët pacienti referon se ka edhe sot. Shëmtim trupor nuk ka. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka. Ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 3 javë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 30 ditë. Rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm për 2 javë por nuk ka bërë.

Me administrimin e ekspertizës së psikiatrisë të Dr. N.F të datës 05.12.2023, i cili ka deklaruar se ekspertizën respektivisht raportin dhe mendimin e tij ka konstatuar se paditësja S.B ka pësuar: frikë primare ka përjetuar frikë primare 2 sekonda në momentin kur e ka perceptuar goditjen nga automjeti tjetër dhe rrezikun fatal të vdekjes. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit lartë - 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm - një muaj, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, nevojën e trajtimit të mëtejshëm mjekësorë, ndihmën e personit tjetër për shkak paaftësisë si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitet të ultë që është duke vazhduar ende e manifestuar me frikë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm si dhe në vështirësi në përfshirje të aktiviteteve të lidhura me komunikacionin.

Duke miratuar kërkesëpadinë e paditësit A.K më afër të përshkruar sikurse në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka ardhur në përfundim se është argumentuar fakti se e paditura ka për obligim që paditësit të i'a kompensojë dëmin material si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga shkaktari i aksidentit shoferi i motokultivatorit A.

Duke miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses B.B më afër të përshkruar sikurse në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka ardhur në përfundim se është argumentuar fakti se e paditura ka për obligim që paditëses të i'a kompensojë dëmin material dhe jo material si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga shkaktari i aksidentit shoferi i motokultivatorit A.

Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, gjykatës i rezultoi se kërkesëpadia e paditëses përtej shumës së aprovuar është kërkesë e pabazë, pasi gjykata vlerësoi se shumata e gjykuara janë të përshtatshme dhe në përputhje edhe me natyrën e lëndimeve të paditëses B.B. Duke i marrë parasysh këto gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit në lidhje me dëmin material pasi që caktimin i shumës më të lartë nuk do të ishte në proporcion me dëmin e pësuar nga këtu paditësja.

Gjykata ka vendosur që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses S.B, që e paditura t'ia paguaj në emër të rehabilitimit fiziko-terapeutik shumën prej 500,00 Euro, si e pabazuar, ngase edhe pse në bazë të mendimit të Dr. I.S, ka qenë i nevojshëm dy javë mirëpo paditësja nuk ka e ka bërë.

Sipas dispozitës së nenit 18.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja,” ndërsa në nenin 20.2 të njëjtit ligj parasheh se 2. Personi fizik i dëmtuar ka të drejtë dëmshpërblimi për dëmet që vijnë si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore apo përkeqësimit të shëndetit deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të këtij ligji.*

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të nenit 18.1 dhe 20.2, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, nenit 177, dhe 183 të LMD-së, vlerësojë se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditëses me rastin e shkaktimit të lëndimeve trupore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata është mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, ashtu që janë të detyruar të paditurat që të kompensojnë shpenzimet që i referohen përfaqësuesit të palës paditëse atë për taksën për padi 21,00 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 156,00 euro, për 5 seanca gjyqësore në shumën prej $5 \times 202,00 = 1,010.00$ euro, për ekspertizat të ortopedisë dhe psikiatrisë shumën prej 300,00 euro, për ekspertizë të komunikacionit shumën prej 150,00 €, për ekspertizë të makinerisë shumën prej 150,00 €, si dhe diferencën e taksës shumën prej 40,00 €, ku totali i shpenzimeve është 1,827.00 Euro.

Gjykata ka vendosur si në pikën VII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se shpenzimet tjera për përpilimin e parashitësive të kërkuara nuk hyjnë në shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës gjyqësore konform nenit 452 të LPK-së.

OBLIGOHEN paditësit K.B dhe S.B që në emër të diferencës së taksës gjyqësore të paguajnë shumën prej 40,00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.649/2022, më datë 27.03.2024

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit–Divizioni Civil në Prishtinë.